



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 8699/4 prot.

Elbasan, me 28.10.2024

VENDIM

Nr. 53, datë 28.10.2024

PËR
PAGESËN E KOMISIONEVE AD-HOCC

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 157, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar, VBA Nr. 09 , datë 23.02.2024 "Për miratimin e planbuxhetit të vitit 2024 në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", i ndryshuar, VBA nr. 52, datë 28.12.2023 "Për pagesën e honorareve të komisioneve të disa komisioneve në UE", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Komisionet apo grupet e punës (punonjës efektivë në UE) të ngritura me vendim, ose urdhër të organeve apo autoriteteve drejtuese: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektori i Universitetit, Administratori i Universitetit, angazhohen në procese të caktuara pune, që nuk lidhen me veprimtarinë e përditëshme apo detyrave funksionale të njësive të UE-së , të paguhen sipas përcaktimeve në VBA-në nr. 52, datë 28.12.2023 "Për pagesën e honorareve të komisioneve të disa komisioneve në UE",
2. Pagesa për secilin student në komisioneve zgjedhore 2024 të jetë:
 - a) Për Komisionin Institucional Zgjedhor (KIZ) përfaqësuesi i studentëve 1 antarë me 40,000 lekë.
 - b) Për Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve (KZF) të shpërblehen përfaqësues të studentëve 5 antarë me 40,000 lekë
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durrmishi

